



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 7 pika 1.24 të Ligjit nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në mbledhjen e 275-të, mbajtur më datë 21 janar 2022, miraton këtë:

RREGULLORE Nr. 01/2022

PER THEMELIMIN E KOMITETIT KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen rregullat për themelimin dhe funksionimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore dhe procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit.
2. Ky Komitet do t'i ndihmoj gjyqtarët me informacione dhe këshilla rreth pyetjeve apo çështjeve etike të identifikuar për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
3. Komiteti do të shërbejë si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si t'i trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
4. Puna e Komitetit dhe procesi disiplinor janë të ndara dhe të pavarura njëri nga tjetri. Opinionet e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore jepen lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, për dallim nga procesi disiplinor ku përfshihen hetimet dhe seancat e mundshme që shqyrtojnë dhe zgjidhin ankesa për sjelljet e pretenduara jo etike të gjyqtarëve në të kaluarën.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore** - nënkupton grupin e përbërë nga gjyqtarët e zgjedhur nga Këshilli, të cilët ofrojnë këshilla si t'i trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
 - 1.2. **Kodi i Etikës** - nënkupton Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.
 - 1.3. **Ligji** - nënkupton Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
 - 1.4. **Këshilli** – nënkupton Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç është përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Neni 3 Parimet e punës së Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore

1. Puna e Komitetit bazohet në parimet si në vijim:
 - 1.1. **Parimi i Ligjshmërisë** - gjatë dhënies së opinioneve Komiteti mbështetet/bazohet në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.
 - 1.2. **Parimi i pavarësisë** - anëtarët e Komitetit gjatë ushtrimit të funksionit janë të pavarur, të paanshëm dhe të pandikuar në çfarëdo mënyre.
 - 1.3. **Parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare** - nënkupton që anëtarët e Komitetit kanë për obligim ta ruajnë emrin e gjyqtarit dhe gjykatës i cili ka bërë kërkesë për dhënie të opinionit këshillëdhënës të etikës.

Neni 4 Përzgjedhja e anëtarëve të Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore

1. Këshilli propozon gjyqtarët që do të shërbejnë në Komitetin Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, të cilët zgjidhen me shumicë të votave të anëtarëve të Këshillit.
2. Komiteti Këshillëdhënës për Etikë përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, prej të cilëve dy (2) anëtarë vijnë nga radhët e Gjykatës Supreme, dy (2) anëtarë nga radhët e Gjykatës së Apelit dhe një (1) nga radhët e nivelit të gjykatave themelore të Kosovës. Përbërja e Komitetit duhet të pasqyrojë strukturën etnike dhe gjinore.
3. Mandati i anëtarëve të këtij Komiteti është tre (3) vite me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
4. Mandati i anëtarëve të Komitetit gjatë tre (3) viteve, të para do të përcaktohet në këtë mënyrë:

- 4.1. Tre (3) prej anëtarëve duhet të kenë mandat prej tre (3) vitesh dhe dy (2) anëtarë duhet të kenë mandat prej dy (2) vitesh.
5. Procedura e përcaktimit të mandatit bëhet me short. Pas raundit të parë të zgjedhjes së anëtarëve për të shërbyer në Komitet, të gjithë anëtarët e tjerë do të kenë mandat të rregullt.
6. Anëtarët për të shërbyer në këtë Komitet duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 6.1. të kenë reputacion të lartë profesional;
 - 6.2. të kenë integritet të lartë moral dhe etikë profesionale;
 - 6.3. të kenë së paku tetë (8) vite përvojë pune si gjyqtar;
 - 6.4. të mos jetë aktualisht subjekt i një hetimi disiplinor;
 - 6.5. të mos kenë të shqiptuar sanksion disiplinor gjatë pesë (5) viteve të fundit.
7. Anëtarët e Këshillit, Kryetarët e Gjykatave dhe anëtarët e listës së paneleve hetimore nuk duhet të jenë anëtar të këtij Komiteti.
8. Gjyqtarët të cilët caktohen si anëtarë të Komitetit kanë për obligim të jenë në dispozicion për të shërbyer në Komitet dhe të koordinojnë punën e tyre në bashkëpunim me Kryetarin e gjykatës. Për angazhimet në Komitet nuk do të kenë kompensim.

Neni 5

Kryetari i Komitetit dhe kompetencat

1. Kryetari i Komitetit caktohet nga Këshilli, në parim nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme që është anëtarë i Komitetit.
2. Kryetari i Komitetit ka këto kompetenca:
 - 2.1. thërret dhe udhëheq takimet e Komitetit;
 - 2.2. me kërkesë të Këshillit, përgatitë dhe paraqet raportet për punën e Komitetit;
 - 2.3. përfaqëson Komitetin në takime të ndryshme;
 - 2.4. pas votimit nga Komiteti, përgatitë dhe nënshkruan opinionet.

Neni 6

Kërkesa për dhënien e opinioneve

1. Kryetarët dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve të gjykatave, mund t'i drejtohen Komitetit me kërkesa për dhënie të opinioneve, lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
2. Njësia për Inspektim Gjyqësor cakton stafin mbështetës për Komitetin.

3. Zyra e IT-së në SKGJK, krijon një adresë elektronike për Komitetin e cila menaxhohet nga stafi mbështetës.
4. Stafi mbështetës do t'i njoftojë të gjitha gjykatat në lidhje me adresën elektronike dhe të drejtën e kryetarëve dhe gjyqtarëve për të dërguar kërkesa për dhënien e opinionëve nga Komiteti.
5. Për secilën kërkesë të pranuar, stafi mbështetës e njofton Kryetarin e Komitetit dhe në bashkëpunim caktojnë takimin për shqyrtimin e kërkesës.
6. Takimi i Komitetit duhet të caktohet jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e pranimit të kërkesës, ndërsa stafi e dërgon ftesën dhe materialin tek anëtarët e Komitetit.

Neni 7 **Shqyrtimi i kërkesës**

1. Komiteti mund të refuzoj kërkesën për dhënien e opinionit këshillëdhënës nëse konstaton se kërkesa është e pavend apo është paraqitur në lidhje me situatat apo sjelljet të cilat kanë ndodhur në të kaluarën të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
2. Nëse kërkesa është jo e plotë dhe e paqartë, Komiteti mund të kërkojë informacione dhe sqarime plotësuese nga parashtruesi i kërkesës, i cili është i obliguar që të veprojë brenda afatit prej 3 (tre) ditëve.
3. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti e hedh poshtë kërkesën e parashtruesit.

Neni 8 **Opinionet me vetiniciative**

Komiteti mund të nxjerr opinion këshillëdhënës me vetiniciative, për çështjet me interes të përgjithshëm për etiken gjyqësore.

Neni 9 **Takimet e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore**

1. Takimet e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore udhëhiqet nga Kryetari i Komitetit. Në mungesë të Kryetarit të Komitetit, takimi udhëhiqet nga anëtari më i vjetër i pranishëm në takim.
2. Për mbajtjen e takimit, Komiteti duhet të ketë kuorum prej tre (3) anëtarëve të pranishëm.
3. Në mënyrë që të nxjerrin një opinion këshillëdhënës të etikës, nevojitet që shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm të votojnë pro.

4. Takimet e Komitetit mbahen në objektin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe janë të mbyllura për publikun.
5. Komitetit i ofron ndihmë administrative Njësia për Inspektim Gjyqësor.

Neni 10 **Opinionet e Komitetit Këshillëdhënës**

1. Forma e opinionëve këshillëdhënësë duhet të jetë:
 - 1.1. hyrja, përfshirë bazën ligjore për nxjerrjen e opinionit;
 - 1.2. paraqitja e përshkrimit të çështjes;
 - 1.2. përmbledhje e shkurtër e kërkesës;
 - 1.3. faktet përkatëse mbi të cilat mbështetet opinionit;
 - 1.4. gjetjet dhe rekomandimet e Komitetit;
 - 1.5. arsyetimi i opinionit, duke cituar Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, si dhe mund t'i citoj dispozitat e zbatueshme ndërkombëtare, çështjet gjyqësore të mëparshme, vendimet e mëparshme të etikës, etj.
2. Opinioni i Komitetit Këshillëdhënës i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të Këshillit, në pajtim me ligjin dhe akteve nënligjore të zbatueshme.

Neni 11 **Trajnimi për anëtarët e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë do të organizojnë trajnim për anëtarët e Komitetit.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli.

Prishtinë, më datë 25.01.2022

Albert Zogaj
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

